

SHENIME SHPJEGUESE PER PASQYRAT FINANCIARE 2020

Shoqëria “HEC Drita Energji” shpk është regjistruar si person juridik dhe pajisur nga organet tatimore me NIPT L99524601K me objekt aktiviteti Prodhim dhe tregti energji.

I. POLITIKA KONTABEL

Njësia ekonomike për hartimin e pasqyrave financiare për periudhën 01/01/2020 – 31/12/2020 është mbështetur në Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të Shqipërisë, SKK.15 “Për Mikronjësitet”.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e konceptit të materialitetit që nënkupton dhënien rëndësi atyre aspekteve dhe të dhënave financiare të veprimtarive ekonomike që janë të rëndësishme për përdoruesit e pasqyrave financiare, e që mund të ndikojnë në vendimet ekonomike që ata marrin.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Kështu efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin dhe regjistrohen në kontabilitet dhe raportohen në pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin.

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve është sipas natyrës dhe është hartuar sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Fitime/humbja e vitit raportues është e barabartë me fitimin e raportuar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

II. PARIMET PËR PËRGATITJEN E PASQYRAVE FINANCIARE

(a) ***Kuptueshmëria:*** Informacioni në pasqyrat financiare duhet të paraqitet në mënyrë të tillë që ai të jetë informues dhe pa ekuivok, për ata përdorues të pasqyrave financiare që kanë njohuri të mjaftueshme në fushën e financës, për të kuptuar pasqyrat financiare.

(b) ***Rëndësia:*** Në përgatitjen e pasqyrave financiare rëndësi u duhet vënë atyre aspekteve dhe të dhënave financiare të veprimtarive ekonomike që janë të rëndësishme për përdoruesit e pasqyrave financiare, e që mund të ndikojnë në vendimet ekonomike që ata marrin. Rëndimi i pasqyrave financiare me hollësi të tepruara dhe informacion jomaterial dëmton qartësinë dhe kuptueshmërinë e tyre.

(c) ***Besueshmëria:*** Për të qenë i dobishëm, informacioni duhet të jetë i besueshëm. Informacioni mbart cilësinë e besueshmërisë, kur ai është i paanshëm dhe nuk mbart gabime materiale, si dhe kur përdoruesit mbështeten mbi të, duke pasur besim që ky informacion është një prezantim besnik i asaj që ky informacion përpiqet ose pritet në mënyrë të arsyeshme të prezantojë. Informacioni mund të jetë i vlefshëm të paraqitet, por në të njëjtën kohë ai mund të jetë aq i pabesueshëm për nga natyra ose nga mënyra e prezantimit sa që paraqitja e tij mund të keqinformojë lexuesin. Për shembull, nëse baza ligjore apo shuma e një kërkesë për zhdëmtim në një proces gjyqësor është e diskutueshme, atëherë nuk do të ishte e drejtë që një njësi ekonomike raportuese ta njihë shumën e plotë të dëmit në bilanc, por, nga ana tjetër, do të ishte e drejtë që shuma dhe rrethanat, në lidhje me dëmin, të përshkruheshin në shënime shpjeguese.

(d) **Krahasueshmëria:** Qëndrueshmëria në politikat kontabël, paraqitja edhe në formatin e pasqyrave financiare është e nevojshme për një krahasim objektiv të treguesve të performancës financiare të njësisë ekonomike raportuese në vite. Kërkesat standarde për politikat kontabël, formatet e përgatitjes së informacionit financiar, si dhe informacioni që duhet paraqitur në pasqyrat financiare përbëjnë bazën për krahasimin e të dhënave financiare të njësisë të ndryshme ekonomike raportuese.

(e) **Kompesimi:** Aktivitetet e pasivitetit dhe të ardhurat e shpenzimit nuk kompesohen me njëra-tjetrën me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë kërkohet ose lejohet nga një standard kombëtar i kontabilitetit.

III. SHENIMET QE SHPJEGOJNE ZERAT E PASQYRAVE KRYESORE.

A – Bilanci kontabel - Aktivitetet

I Aktivitetet Afatshkurtera

Totali i Aktiviteteve Afatshkurtera paraqiten ne shumen totale 925.813 leke.

1. Aktivitetet monetare

Gjendja e mjeteve monetare ne arke dhe ne banke paraqiten ne shumen 925.813 leke.

B. Bilanci Kontabel - Detyrimet.

I. Detyrimet afatshkurtra.

1. Te pagueshme per aktivitetet shfrytezimi

Shuma 10.145 leke eshte detyrim ndaj Sigurimit shoqerore dhe shendetesore te papaguara.

II. Detyrimet afatgjata .

1. Te drejtat dhe detyrimet

Detyrimet ndaj shoqerise meme Breçani R.O.S.P. shpk paraqiten ne shumen 1.702.746 leke.

III. Kapitali

Kapitali i rregjistruar paraqitet ne shumen 100.000 leke.

Humbje e mbartur paraqiten ne shumen 251.857 leke

Humbje te periudhes financiare 2020 paraqiten ne shumen 635.221 leke.

Administrator

Eralbi BREÇANI

